

Buletini i **NFFIS dhe ECO-DRR** për Ballkanin Perëndimor

Ndërtimi i kapaciteteve për Zvogëlimin e Rreziqeve nga Katastrofat përmes Sistemit Kombëtar të Informacionit për Zjarret Pyjore (NFFIS) dhe Eco-DRR
Mars 2021 - Shkurt 2026

Ndërtimi i kapaciteteve për Zvogëlimin e Rreziqeve nga Katastrofat përmes Sistemit Kombëtar të Informacionit për Zjarret Pyjore (NFFIS) dhe Eco-DRR

Qëllimi i këtij projekti është të fuqizojë kapacitetet e zyrtarëve qeveritarë në parandalimin dhe zbutjen e zjarreve pyjore dhe katastrofa të tjera natyrore përmes krijimit të NFFIS dhe Eco-DRR. Vëllimi 1 shpjegon sfondin, skicën dhe aktivitetet e projektit.

Sfondi

Në mënyrë që të kontribuojë në parandalimin dhe zbutjen e zjarreve në pyje dhe fatkeqësi të tjera natyrore të zakonshme në rajon, sistemi i informacionit për zjarret në pyje dhe Eco-DRR i zhvilluar në projektin në Maqedonin e Veriut, mbështetur nga JICA do të zgjerohet për të përmirësuar kapacitetin e zyrtarëve qeveritarë në Nismën* e Bashkëpunimit të Ballkanit Perëndimor.

Kjo synon të mbështesë reformat socio-ekonomike në vendet e Ballkanit Perëndimor drejt pranimin në BE, si dhe të lehtësojë bashkëpunimin në rajon.

【Partnerët】

MPB-Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave (AME)

MBPZHR– Agjencia Pyjore e Kosovës (KFA),

Instituti Hidro Meteorologjik i Kosovës

(IHMK), të tjerë



Përmbajtja

【Emri i Projektit】

Ndërtimi i Kapaciteteve për zvogëlimin e Rreziqeve nga Katastrofat përmes Sistemit Kombëtar të Informacionit për Zjarret Pyjore (NFFIS) dhe Eco-DRR

【Zona e Synuar】

Kosovë : Restelicë, Istog

Mal i Zi : Ulqin, Kolashin

【Periudha】

Maj 2021 ~ Shkurt 2026 (5 vite)



MB – Drejtoria për Shpëtim dhe Mbrojtje (DSM)


MARD- Drejtoria për Pylltari dhe Industrinë e drurit, (DFHWI), Drejtoria për Ndryshime Klimatike,



Instituti për Hidrometeorologji dhe Seizmologji, (IHMS), të tjerë

Çfarë është NFFIS? (Rezultati 1)

NFFIS (Sistemi kombëtar i informacionit për zjarret pyjore) është një sistem i integruar Web-GIS për parandalimin e zjarreve dhe paralajmërimin e hershëm që lejon shkëmbimin e informacionit me agjencitë përkatëse.



Duke kombinuar informacionin satelitor dhe të motit me hartat topografike, është e mundur të monitorohet se ku ka të ngjarë të ndodhin zjarre, sa lehtë përhapen zjarret dhe sa e thatë është zona. Ky informacion mund të përdoret për paralajmërim të hershëm.


-Pamjet janë nga Maqedonia e Veriut.

Çfarë është Eco-DRR? (Rezultati 2)

Ekosistemet kanë funksione të shumfishta, për shembull pyjet kanë një numër funksionesh përveç prodhimit të drurit, të tilla si ruajtja e tokës dhe pellgut ujëmbledhës, rekreacioni dhe biodiversiteti.


"Eco-DRR (Zvogëlimi i rrezikut nga katastrofa i bazuar në ekosistem)" është menaxhimi i qëndrueshëm, konservimi dhe restaurimi i ekosistemeve për të zvogëluar rrezikun e katastrofës, me qëllim të arritjes së një zhvillimi të qëndrueshëm dhe të rigjenerueshëm.

Kosovë : Ripyllëzimi kundër orteqeve



Mal i Zi : Pyllëzim Bregdetar DRR

Projekti identifikoi çështjet në peizazhin bregdetar duke përdorur një qasje peisazhi dhe duke krijuar harta të përdorimit të tokës nga një rishikim i literaturës dhe analiza e GIS. Më pas, aktivitetet e ndërgjegjësimit dhe edukimi mjedisor për banorët dhe sektorin e turizmit do të bëhen për të promovuar Eco-DRR.



Komiteti i parë i Përbashkët Koordinues


Komiteti i Përbashkët Koordinues është mbajtur për Kosovën, më 27 Prill 2021, nën kryesimin e Z. Fadil KODRA, Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Menaxhimit të Emergjencave (EMA), dhe për Malin e Zi, më 07 Qershor 2021, nën kryesimin e z. Ljuba TMUSIC, Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Shpëtimit dhe Mbrojtjes. Pjesëmarrës ishin Përfaqësues nga JICA, Ambasada Japoneze dhe Ekipi i Ekspertëve nga JICA.

U prezantua përmbajtja e Projektit, u shkëmbyen pyetje dhe diskutime ku Mali i Zi dhe Autoritetet Japoneze u pajtuan që të filloj zbatimi i Projektit.



←
Kosovë

Mal i Zi →



Facebook i Projektit
<https://www.facebook.com/WestBalkanNFFISandEcoDRRproject>



MPB- Agjencia për Menaxhim Emergjent (AME)



MB- Drejtoria për Shpëtim dhe Mbrojtje (RPD)



Agjensioni Japonez për Bashkëpunim Ndërkombëtar (JICA)